

Datë 15.02.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “RIPARIM E MIRËMBAJTJE SISTEMESH TË
NGROHJE-FTOHJEVE” PËR SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **45259000-7**

VLERA E FONDIT LIMIT: **2,481,520 (dy milion e katërqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e njëzetë) Lekë (pa TVSH).**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.;

b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i licensuar sipas dispozitave perkatëse ligjore dhe nen ligjore. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Licencë profesionale të shoqërisë**, të

lëshuar nga institucioni përgjegjës i ngarkuar me ligj, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, ku të përfshihet të paktën **kategoria** e mëposhtme:

- **NS12-A** Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqese xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020, 2021 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40 % te fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

2.3 Kapaciteti teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror dhe/ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e kryera.
 - Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmin përkatëse, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe **të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimeve të realizuara.

Argumentimi ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori/et ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht të punësuar, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Drejtues teknik –Inxhinier teknik /Hidroteknik/Elektrik	1 (nje)
Punonjës/Specialist për sistem ngrohje ftohjeve/kondicioner	2 (dy)
Punonjës elektrikist	1 (dy)
Total	4 (katër)

a) Për drejtuesin teknik të paraqitet:

- Diplomë me profesion Inxhinier Teknik/Hidroteknik/ Elektrik.
- Kontrate pune perkatëse.
- Librezë pune, ose cdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën perkatëse.
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të lëshuar nga e - albania.
- Në zbatim të akteve ligjore, drejtuesi i mesipër nuk duhet të figurojë i dy punësuar në sektor privat apo publik. Për këtë Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqërisë të paraqesë deklarate perkatëse.

b) Për punonjësit Specialist për sistem ngrohje ftohje/kondicioner, të paraqitet:

- Çertifikatë kualifikimi, në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.

- Kontrate pune perkatese.
- Libreze pune ose cdo dokumentacion tjetër qe verteton eksperiencen perkatese.

c) Për punonjësit Specialist Elektricit, te paraqitet:

- Çertifikatë kualifikimi, në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.
- Kontrate pune perkatese.
- Libreze pune ose cdo dokumentacion tjetër qe verteton eksperiencen perkatese.

Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve te punes
----	--------------	------------	---

Shënim: Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues që të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar te cdo punonjësi pranë AK.

Shënim: Me qëllim garantimin e gjithë perfshirjes, për ti dhene mundesi cdo operatori ekonomik për te marrë pjesë ne procedurën perkatese te prokurimit, punonjësit e mesiperm jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjësit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Argumentimi ligjor : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/a,b,c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

3.Operatori ekonomik duhet të deklaroj se merr përsipër kryerjen e riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic jane sherbim ngrohje ftohjeve eshte e nevojshme një staf i kualifikuar. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar ne nevojën për kryerjen e shërbimeve si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve qe kerkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës për realizimin e objektit.

4. Operatori ekonomik duhet të deklaroj Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit duhet të ofrohen të reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi.

5. Operatori ekonomik në lidhje me Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit që do të përdoren gjatë realizimit të shërbimeve të percaktuara në shtojcën 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafiku i ekzekutimit, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet të leshuara nga një organ i akredituar.

Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit			Spitali Universitar I Traumës.
Nr.	Emërtimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent
1			
2			

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate synohet që pajisjet që do të përdoren për riparime dhe furnizim vendosje të jenë të reja dhe që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për autoritetin kontraktor të përfshirë në këtë procedurë, riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbim pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë të lind nevoja.

Shënim: Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues që të dorëzojë certifikatat e cdo produkti pranë AK.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kritereve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Data e publikimit të njoftimit është **16.02.2023** dhe data e zhvillimit të procedurës së prokurimit elektronik është **28/02/2023 ora: 11:00** në faqen e internetit www.app.gov.al, në Ministrinë e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.